Në aktivitetet të 3R ku synohet një shoqëri të shëndoshë, thuhet, "Fshhtë burim nëse ndahet por është mbeturinë nëse përzihet ". Pastaj, KeP do të prezantojë sistemin e ndarjes në burim, ku mbeturinat klasifikohen në mbeturina organike dhe inorganike para se të përzihen në burim dhe sistem		

grumbullimi ndaras të materialeve të kompostueshme dhe të reciklueshme.....	29
5.3.2 Prezantimi i premisave për trajtim të ndërnjetëm për promovimin e minimizimit të mbeturinave.....	31
5.4 Krijimi i një Menagjimi të përshtatshëm të Deponisë.....	32
5.4.1 Vazhdimi i monitorimit të deponisë ekzistuese.....	32
5.4.2 Krijimi i menagjimit të qëndrueshëm të deponimit final.....	33
6 Masat Bugjetore.....	34
1 Gjendja dhe problemet e MMN në 2011.....	1
2 Supozimet për Planifikim.....	5
2.1 Popullsia dhe shkalla e rritjes ekonomike.....	5
2.2 Sasia dhe përbërësit e mbeturinave në të ardhmen.....	6
2.2.1 Sasia e mbeturinave që gjenerohen.....	6
2.2.2 Përbërja e mbeturinave në të ardhmen.....	8

SHTOJCA 1: Gjendja dhe problemet e MMN në 2011

SHTOJCA 2: Komiza për Planifikim

Shkurtesat

C/P	Counterpart/Partnerët
CA/VK	Capacity Assessment/Vlerësimi i Kapaciteteve
CAS/SVK	Capacity Assessment Survey/Studimi i vlerësimit të kapaciteteve
CI/IK	Capacity Inventory/ Inventari i kapaciteteve
DF/R-DRF	Draft Final Report/ Draft Raporti Final
DOCUST/DOKUFEST	International Documentary and Short Film Festival/ Festivali Ndërkombëtar i filmit të shkurtër
Ekoregjioni RWC KRM Ekoregjioni	Ekoregjioni Regional Waste Company/Kompania Regjionale Ekoregjioni
F/R- R/F	Final Report/ Raporti Final
GTZ (GIZ)	Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit/ Agjensioni për bashkëpunim Teknik
IC/R / RF	Inception Report/ Raporti Fillestar
JCC/ KPK	Joint Coordinating Committee / Komisioni i përbashkët Koordinues
JICA	Japan International Cooperation Agency/ Agjensioni Japonëz për Bashkëpunim Ndërkombëtar
KLMC/ KMDK	Kosovo Landfill Management Company/ Kompania për Menagjimin e Deponive të Kosovës
MEI/MIE	Ministry of European Integration/ Ministria e Integritimeve Europiane
MESP/MMPH	Ministry of Environment and Spatial Planning / Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
M/P- P/M	Master Plan / Plani Master
P/R- R/P	Progress Report / Raporti i Progresit
Pastrimi PC KRM Pastrimi	Pastrimi Public Company / Kompania Regjionale Pastrimi
PDM / FPD	Project Design Matrix / Forma e Projekt Dizajnit
PO	Plan of Operation / Plani i Operimit
POS/ SOP	Public Opinion Survey / Studimi i Opinionit Publik
SDC	Swiss Agency for Development and Cooperation / Agjensioni Zvicëran për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SWM/ MMN	Solid Waste Management/ Menagjimi i Mbeturinave të Ngurta
T&M Survey/Studimi i K&L	Time and Motion Survey / Studimi i Kohës dhe Lëvizjes
USAid	United States Agency for International Development/ Agjensioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
W/P/ P/P	Work Plan / Plani i Punës
WACS/SPSM	Waste Amount and Composition Survey/ Studimi i sasisë dhe përbërjes së mbeturinave
WWRO/ZRRUM	Water and Waste Regulatory Office / Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina

1 Qëllimi i Planit për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta

1.1 Sfondi i P/M për MMN

Ligji i mbeturinave u rishikua dhe hyri në fuqi në Qershor, 2012. Ky ligj përshkruan në mënyrë të qartë se pushteti lokal duhet të marrë përgjegjësinë e menaxhimit të mbeturinave të gjeneruara në juridiksionin e vet në bazë të politikës së decentralizimit.

Komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejshëm "KeP") ka filluar "Projekti për mirjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave të ngurta në drejtim të shoqërisë së shëndoshë" (në tekstin e mëtejshëm i referohemi si "Projekti") në bashkëpunim me JICA në shtator, 2011 . Projekti ka ekzekutuar anketat paraprake bazë që nga Shtatori 2011 deri në Mars 2012, dhe ka sqaruar problemet e një menaxhimenti aktual të mbeturinave. Pastaj është hartuar drafti i parë i planit master për menaxhimin e mbeturinave të Ngurta (2012-2020) përlshirë propozimin për zgjidhjen e problemeve dhe është përgatitur poashtu plani i pilot projekteve për të verifikuar efikasitetin e sistemit teknik të propozuar.

KeP bëri planin e parë 5-vjeçar për MMN sipas ligjit të mbeturinave bazuar në draftin e parë të planit master të MMN, bazuar në përvojën e pilot projekteve të përbërë nga grumbullimi me këmbanë dhe zgjerimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, të miratuar nga Kuvendi në Korrik 2013. Plani i parë 5-vjeçar i MMN përlshin krijimin e sektorit të menaxhimit të mbeturinave, futjen e taksës së mbeturinave, kontraktimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, krijimin e një komisioni këshillues për të mbikqyrur kontraktorët, dhe një sistem si ky nuk ekziston ende në Kosovë. Ka qenë e nevojshme të bëhen aranzhime institucionale për të zbatuar planin 5 vjeçar të MMN, dhe në Shtator 2013 KeP ka përgatitur rregulloren për menaxhimin e mbeturinave.

KeP ka filluar me sistemin e ri të menaxhimit të mbeturinave të Ngurta (taksa për mbeturina, kontraktimi i shërbimit të grumbullimit dhe mbikqyrja nga komisioni këshillues) që nga Janari 2015 bazuar në planin e parë 5 vjeçar të MMN.

Ky Plan Master për menaxhimin e mbeturinave të ngurta (në tekstin e mëtejshëm "P/M/MMN") është bërë duke rishikuar draft planin e parë të MMN, bazuar në rezultatet e pilot projekteve dhe përvojën e fituar nëpërmjet zbatimit të Projektit. Ky master plan për MMN është bërë si një plan afatgjatë për menaxhimin e mbeturinave duke marrë në konsideratë planin e dytë 5 vjeçar për MMN (2019-2023).

1.2 Pozita e PL/MMN brenda sistemit ligjor të Kosovës

Ky P/M/MMN parasheh një plan afatgjatë të përshtatshëm të KP deri në vitin 2023 bazuar në Strategjinë Kombëtare për menaxhimin e mbeturinave siç është edhe e përcaktuar në Nenin 17 të Ligjit mbi Mbeturinat.




Figura 1: Gjendja Ligjore e Planit Master për MMN

2 Gjendja aktuale dhe problemet e Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta (MMN) në Komunën e Prizrenit

Për të kuptuar gjendjen aktuale të menaxhimit të mbeturinave në Prizren, Ekipi i Ekspertëve Japonez (në tekstin e mëtejshëm i referohemi si "JET") për Projektin për Ngritjen e kapaciteteve për Menaxhimin e mbeturinave drejt një Shoqërie të Shëndoshë (në tekstin e mëtejshëm i referohemi si "Projekti") ka bërë studime përmbajtësore. Pastaj, JET ka bërë edhe një detyrë të mbeturinave bazuar në rezultatet e studimeve përmbajtësore dhe ka identifikuar problemet e menaxhimit aktual të mbeturinave.

Tabela 1: Studimet Përmbajtësore të kryera

Studimet	Periudha e Implementimit
Studimi i Sasisë dhe Përbërjes së Mbeturinave	Verës: 28 Shk. – 5 Tet. 2011 Dimër: 6 Mar. – 13 Mar. 2012
Studimi i Kohës & Lëvizjes	13 Tet. – 3 Nën. 2011
Studimi i Opinioneve Publike dhe Bizneseve afërisht	Mes. Tet. – Mes. Dhj. 2011
Studimi i Reciklimit	14 Tet. – 8 Nën. 2011
Studimi i Tregut të Kompostit	Mes. Tet. – Mes. Nën. 2011

Të dhënat e përdorura në këtë P/M për MMN, janë ato të cilat janë parashikuar bazuar në vlerat e siguruarat përmes studimeve përmbajtësore.

2.1 Sasia dhe përbërja e mbeturinave

2.1.1 Sasia e mbeturinave

Sasia e mbeturinave vlerësohet duke shumëzuar numrin e burimeve gjeneruese me shkallën e gjenerimit të mbeturinave.

Shkalla e gjenerimit të mbeturinave është marrë nga rezultati i studimit të sasisë dhe përbërjes së mbeturinave. Në anën tjetër, numri i burimeve gjeneruese zakonisht sigurohet nga të dhënat statistikore. KeP nuk ka qenë në gjendje të dijë numrin e saktë të sipërmarrjeve pasiqë në sistemin mbeten të dhënat e sipërmarrjeve edhe nëse ato sipërmarrje ndalin aktivitetin. Pastaj, KeP ka vlerësuar numrin e burimeve me 2011 sipas zyrës së regjistrimit të bizneseve dhe të dhënat nga tatimi në pronë në bashkëpunim me JET.

Sasia e mbeturinave të gjeneruara në 2011 është vlerësuar si 112.6 ton/ditë. Me këtë shkallë të gjenerimit të mbeturinave komunale është vlerësuar si 626 g/person/ditë.

Tabela 2: Sasia e gjenerimit të mbeturinave në 2011

Kategoria	Shkalla e gjenerimit	Burimet gjeneruese	Sasia e gjeneruar
Amvisëria (urbane)	366 g/person/ditë	95,893 person	35.6 ton/ditë
Amvisëria (Rurale)	381 g/person/ditë	81,367 person	31.5 ton/ditë
Restaurantet	11,910 g/restaurant/ditë	1,186 restaurant	14.1 ton/ditë
Lokalet tjera	1,770 g/Lokal/ditë	4,749 Lokal	8.4 ton/ditë
Pentaritë	2,795 g/Lokal/ditë	904 Lokal	2.5 ton/ditë

Qendrat tregtare	68 g/m ² /ditë	32,690 m ²	2.2 ton/ditë
Zyrat	1,061 g/zyrë/ditë	1,337 Zyre	1.4 ton/ditë
Shkollat	52 g/student/ditë	44,500 student	2.3 ton/ditë
Hotelet	1,132 g/hotel/ditë	34 hotel	0.1 ton/ditë
Tezge tregu	12,008 g/tezge/ditë	657 Tezge	7.9 ton/ditë
Spitali Rajonal ¹	6,000 kg/spital/ditë	1 spital	6.0 ton/ditë
Rruget & parqet	7 g/m ² /ditë	74,350 m ²	0.5 ton/ditë
Total			112.6 ton/ditë

*1: Duke supozuar se shkalla e gjenerimit në spitalin rajonal nuk ndryshon, sasia e gjeneruar në spital mbetet e njëjtë. Shënim: vetëm në spital njesia është për kilogram për ditë.

Ndryshimi për sasi të mbeturinave të gjeneruara nga 2011 deri 2014 tregohet në figurën më poshtë.




Figura 2: Sasia e mbeturinave të gjeneruara nga 2011 në 2014

Një krahasim për rritjen e sasisë së mbeturinave të gjeneruara dhe të popullsisë nga 2011 deri 2014 është paraqitur në tabelën më poshtë. Kjo shkallë e rritjes së popullsisë në këto 3 vjet ishte 2.1% por rritja e sasisë së gjeneruar të mbeturinave komunale ishte 13.8%. Kjo tregon se standardi jetësor i qytetarëve po rritet barabartë me atë European dhe shumë shpejtë po rriten konsumi.

Tabela 3: Krahasim i rritjes së sasisë së gjeneruar të mbeturinave dhe popullsisë

	2011	2012	2013	2014
Sasia e gjeneruar e mbeturinave (ton/vit)	41,092	42,928	44,791	46,782
Proportioni kundrejt vlerave nga 2013	-	4.5%	9.0%	13.8%
Popullsia (person)	179,869	181,256	182,480	183,595
Proportioni kundrejt vlerave nga 2013	-	0.8%	1.5%	2.1%

2.1.2 Përbërja e Mbeturinave

Përbërja e Mbeturinave nga 2012 deri 2014 është parashikuar bazuar në atë të vitit 2011 të siguruar nga studimi i sasisë dhe përbërjes së mbeturinave.

Sipas parashikimit më lartë, mbetjet organike të cilat janë të kompostueshme në këto tre vite janë duke u rritur gradualisht, mbeturinat e riciklueshme janë duke u rritur dhe mbetjet nga mbeturinat janë duke u zvogëluar.

Proporcioni i mbeturinave organike është rreth 45%. Projekti ka promovuar 90 komposter shtëpiak për të konfirmuar praktikabilitetin e kompostimit të mbetjeve të kuzhinës nga burimet gjeneruese në 2013 dhe ka verifikuar efikasitetin. KeP ka prokuruar 500 komposter shtëpiak për të promovuar kompostimin e mbetjeve organike dhe i ka shpërndarë qytetarëve falas, bazuar në përvojat nga 2014. Pasiqë kompostimi i mbetjeve organike kontribuon jo vetëm në uljen e shpenzimeve për menaxhimin e mbeturinave por edhe gasin metan i cili ka efekt të madh të serës dhe poashtu ka ndikim në kualitetin e ujit të rrjedhur nga deponimi final, dhe për këtë edhe është e nevojshme të vazhdohet me shpërndarjen e komposterëve shtëpiak.

Tabela 4: Përbërja e Mbeturinave

Llojet e Mbeturinave	2011	2012	2013	2014
Mbeturinat e kuzhinës	41.1%	41.4%	41.7%	42.0%
Bari/Druri	2.8%	2.8%	2.8%	2.8%
Mbetje të kompostueshme	43.8%	44.2%	44.5%	44.8%
Letër	13.7%	13.9%	14.2%	14.4%
Plastikë	12.5%	12.7%	12.8%	13.0%
Metal	1.6%	1.6%	1.6%	1.7%
Gjam/Shishe	5.9%	6.0%	6.0%	6.1%
Mbetje të riciklueshme	33.7%	34.2%	34.7%	35.1%
Tekstil	1.8%	1.8%	1.8%	1.8%
Gomë/Lëkurë	0.3%	0.4%	0.4%	0.4%
Qeramike/Guri	0.6%	0.6%	0.6%	0.6%
Dheu/Hiri	12.1%	12.0%	11.9%	11.9%
Tjera	7.7%	7.0%	6.3%	5.6%
Mbetje nga mbeturinat	22.5%	21.7%	20.9%	20.1%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Sidoqoftë, mbetjet e ri-përdorshme dhe të riciklueshme përbëjnë 35%, shkalla e riciklimit me 2011 ishte e ulët në 5.5%. Pasiqë, aktivitetet aktuale të riciklimit janë bërë nga sektorët jo formal, siç janë grumbulluesit e mbetjeve, na duhet një mekanizëm ku qytetarët janë pjesëmarrës, me qëllim të krijimit të një sistemi më efikas të riciklimit.

2.2 Mbeturinat e Amvisërisë dhe Bizneseve

Proporcioni i mbeturinave të amvisërisë, bizneseve dhe nga pastrimi i hapsirave publike në vitin 2011 ishte 59.6%, 39.9%, dhe 0.5% dhe mund të thuhet se shumica e kësaj sasive është mbeturinë që gjenerohet nga amvisëritë dhe bizneset. Nëse shikojmë përbërësit e mbeturinave nga amvisëria ose biznesi, përbërësit e parë organik dhe që riciklohen janë 53% dhe 22.6%, të tjera janë 36.2% dhe 50.7%, dhe këto dallojnë shumë. Nga ky fakt, mund të thuhet se

reciklimi i mbeturinave organike me kompostim mund të ishte shumë efikas për reduktimin e mbeturinave të amvisërisë dhe reciklimi i mbeturinave nga bizneset është efikas për reduktimin e mbeturinave nga biznesi.




Figura 3: Mbeturinat e Amvisërisë dhe Mbeturinat e biznesit




Figura 4: Përbërja e mbeturinave të amvisërisë dhe mbeturinave të biznesit në 2011

2.3 Grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave

Mbeturinat e gjeneruara nga Prizreni janë grumbulluar dhe transportuar në deponinë e Landovicës nga Kompania Regjionale Ekoregjioni dhe nga tre kompani tjera private, të cilat inkasojnë nga klientët (qytetarët) deri në fund të vitit 2014. Nga fakti se inkasimi i pagësës ishte i ulët dhe arrinte 50% deri 60%, Ekoregjioni nuk mundej të siguronte grumbullim të kënaqshëm të mbeturinave. Pas kësaj, kompanitë private shërbenin vetëm ata klientë që paguanin shërbimin. Për këtë arsye qytetarët që nuk kishin shërbim ballafaqoheshin me vështirësi rreth trajtimit të mbeturinave të tyre dhe një pjesë prej tyre ose i djegnin ose i groposnin, kurse pjesa tjetër i shkarkonte ilegalisht nëpër ndonjë hapësirë të lirë dhe buzë rrugës. KeP i ka pastruar këto zona me kaq mundësi sa kanë patur, megjithatë KeP nuk kishte ndonjë zgjidhje në këtë moment për të grumbulluar ato mbeturinat e shkarkuara në zona rurale. Një pjesë e mbeturinave të shkarkuara nëpër skaje të rrugës, nga reshjet e shiut, kanë rrjedhur nëpër lumenjë duke u shpërndarë në shtratin e lumit dhe përgjatë viteve mbeturinat

janë mbledhur skaj rrugës dhe ndalesa të lumit, dhe kështu kanë shëmtuar bukurinë e natyrës.

Ligji i mbeturinave u rishikua në Maj të vitit 2012. KeP ka marrë përgjegjësitë e menaxhimit të mbeturinave, të cilat deri më tani janë menaxhuar nga KRM Ekoregjioni dhe kompanitë private. Për më shumë, ata që trajtojnë mbeturinat aplikojnë për leje nga Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor konform me kërkesat ligjore.

Sipas kësaj situatë, KeP vendosi që të implementoj planin Pesë-vjeçar të MMN dhe u zotua që secilit qytetar ti ofroj të drejtën që të gëzoj shërbim të barabartë të grumbullimit të mbeturinave duke filluar nga Janari i 2015.

2.4 Shkarkimi i Mbeturinave

Sasia përfundimtare që shkarkohej nga KeP nga 2011 deri më 2014 e shënuar nga KMDK paraqitet në tabelën më poshtë. Sipas Ekoregjionit sasia e paraqitur nga KMDK është më e lartë se realja por nuk ekzistojnë baza për verifikimin e saj. Kamionët e grumbullimit të dhuruar nga Japonia në Tetor të vitit 2012, kanë filluar të përdoren në Janar të vitit 2013. Nga të dhënat fillestare (peshë dhe kapaciteti) e kamionëve të rinj janë të sakta dhe të njëjtën edhe KRM Ekoregjioni konfirmon se vlerat e peshës së secilit kamion për sasinë e shkarkimit pas 2013 janë të besueshme .

Tabela 4: Ndryshimi i Sasisë së Shkarkimit final

Viti	2011	2012	2013	2014
Sasia e shkarkuar(ton/vit)	40,039	33,106	32,527	40,361

Burimi i të Dhënave: Kompania për Menagjimin e Deponive të Kosovës (KMDK)

Kapaciteti i mbetur i deponisë së Landovicës është vlerësuar gjatë projektit të cilin KeP e ka implementuar së bashku me JICA-n. Ashtu si dhe është paraqitur në figurën e mëposhtme. Kapaciteti i përgjithshëm i deponisë së Landovicës është vlerësuar të jetë 1.2 milion m³. Është projektuar që kjo deponi të mbushet gjatë vitit 2021 duke marrë parasysh që graviteti specifik i deponisë është parashikuar të jetë 1.2ton/m³.

Për një deponi të re kërkohet një hapësirë e zgjeruar, por do të ishte shumë vështirë që të merret pajtueshmëria nga qytetarët dhe që të zgjidhet një hapësirë e re. Për këtë, është me rëndësi që të përdoret deponia ekzistuese sa më gjatë që të jetë e mundur dhe është esenciale që të reduktohet shkarkimi i mbeturinave.




Figure 5: Kalkulim tri herësh i jetëgjatësisë së deponisë në Landovicë

2.5 Rrjedha e Mbeturinave

Zhvillimi i një rrjedhe të mbeturinave është efektiv për të kuptuar menaxhimin aktual të mbeturinave të ngurta. Ekspertët e Ekipit Japonez (në tekstin e mëtejshëm JET) të Projektit për zhvillimin e Kapaciteteve për Menaxhimin e Mbeturinave drejt një Shoqërie të Shëndoshë (në tekstin e mëtejshëm Projekti) ka krijuar një rrjedhë të mbeturinave duke u bazuar në studimet përmbajtësore.

Rrjedha e mbeturinave është krijuar në bazë të kushteve si më poshtë;

- Mbeturinat nga Amvisëria: Sasia e gjenerimit u vlerësua duke e shumëzuar numrin e popullsisë të marrë nga Regjistrimi i Popullsisë i bërë në vitin 2011 dhe një sasi gjeneruese u marrë nga studimi i përbërjes dhe sasisë së mbeturinave (tani e tutje WACS). Në bazë të raporteve sasia e gjenerimit është e njëjtë sin ë sezonin veror ashtu edhe në atë dimror. Sidoqoftë, dallimi në mes të shkallës së gjenerimit në zona rurale dhe zona urbane është mjaft i lartë; për atë arsye sasia e gjenerimit nga amvisëritë është llogaritur respektivisht.
- Mbeturinat nga Bizneset: Kjo është vlerësuar sipas sasisë së gjeneruar nga restorantët, dyqanet dhe hotelet nga studimi i WACS në vitin 2011 të siguruar nga Komuna e Prizrenit. Numri i burimeve gjeneruese u morr nga të dhënat e lejeve për biznese etj. në vitin 2011 të siguruar nga Komuna e Prizrenit. Sasia e gjeneruar u llogarit nga shkalla e gjenerimit të dhënave të fituara në WACS dhe nga numri i burimeve gjeneruese.
- Mbeturinat nga Ilapësitat publike: Sasia e gjenerimit është e llogaritur sipas rezultateve të të dhënave të shkarkimit të fundit që është pranuar dhe e regjistruar nga KMDK në deponinë e Landovicës.
- Shkalla e reciklimit: Tri vende reciklimi janë marrë si shembuj. E para është reciklimi tek burimi gjenerues, që e quajmë “Reciklimi në vend” sikur që është kompostimi me metoda tradicionale. E dyta është ndarja e të reciklueshmeve nga mbeturinat e shkarkuara, që e quajmë “Grumbullimi i të Reciklueshmeve” përfshirë aktivitetet që kryhen nga punëtorët e grumbullimit të mbeturinave dhe mbledhsit e mbeturinave. E

fundit është ndarja e të reciklueshmeve si trajtim i ndërmjetëm, që e quajmë “Reciklimi larg vendit” e cila bëhet kompanitë private për frumullimin e mbeturinave me qëllim të reduktimit të sasisë për shkarkim. Sasia e Recikluar në secilin aktivitet është vlerësuar në bazë të rezultateve nga opinion publik.

- Shkalla e vetë-shkarkimit: Vetë-shkarkim do të thotë groposja dhe/ose djegja e mbeturinave në burim të gjenerimit. Sasia e vetë-shkarkimit në amvisëri dhe biznese është llogaritur të jetë nga 0.2ton/ditë në zona urbane dhe 0.4ton/ditë në zona rurale, respektivisht duke u bazuar në rezultatet e pyetësorit të kryer gjatë periudhës së WACS dhe SOP.

Derisa e dimë se kishte një dallim të konsiderueshëm zona rurale nga ajo urbane, janë hulumtuar tri rrjedha të mbeturinave, e gjithë zona, zona urbane dhe zona rurale.

Sipas kësaj rrjedhe të mbeturinave, u kuptua që shkalla e grumbullimit në zonat urbane dhe rurale është 78.7% dhe 58.5% respektivisht në periudhën e vitit 2011. Pos kësaj, qytetarët e nga zona rurale i sjellin mbetuimat në zonën urbane dhe i shkarkojnë ato nëpër kontejnere publik.



Mbeturinat e stërbushura në kontejnerët e vendosur në zonën urbane ku krijojnë një shëmti dhe shkaktohet erëra të rënda dhe miza etj. dhe ndjeshëm dëmtojnë mjedisin.




Figura 3: Rrjedha e Mbeturinave në tërë zonën komunale me 2011




Figura 4: Rrjedha e mbeturinave në Zonën Urbane dhe Rurale me 2011

2.6 Problemet me MMN

2.6.1 Përgjegjësitë e Paqarta

Sistemi i MMN deri në fund të 2014 në Qytetin e Prizrenit është i përmbledhur në figurën më poshtë.

KeP ka kontraktuar shërbimin e pastrimit të hapësirave publike (rrugët dhe parqet) me KRM Ekoregjioni dhe 2 kompani tjera private dhe KeP e mbikqyrë aktivitetin që kryhet nga këta kontraktorë. Sidoqoftë, grumbullimi i mbeturinave komunale shkarkuar nga amvisëritë dhe bizneset u ishin lënë në përgjegjësi kompanisë publike dhe atyre private dhe KeP nuk ishte e përfshirë në këtë aktivitet. Për këtë, mbeturinat që ishin shkarkuar ilegalisht në zonat urbane janë larguar përmes pastrimit të hapësirave publike pasiqë trajtimi i mbeturinave të tilla dhe përgjegjësitë nuk ishin të qarta.




Figura 5: Sistemi i Menagjimit të Mbeturinave deri në fund të 2014

2.6.2 Vetëdijësimi i Ulët Publik

Derisa Kosova ishte në një konflikt për një kohë të gjatë, me sa duket që afërsia dhe mbrojtja e fqinjësisë, që e kishte qyteti tanimë ishte humbur. Ne e shohim që qytetarët i mbajnë shtëpitë e tyre të pastra por mbeturinat i shkarkojnë pa brenga kudo që gjejnë vend. Dhe askush nuk thotë gjë për këtë. Pos kësaj shumica e qytetarëve nuk e din se ku përfundojnë mbeturinat e tyre dhe janë indiferent rreth faktit se çfarë po ndodh në deponi.

Jo vetëm qytetarë nga Kosova por edhe shumë të huaj e vizitojnë Prizrenin si një qytet historik me pamje të bukura. Sidoqoftë, pamvarësisht nga mosha ose gjinia, njerëzit në Prizren ende hedhin mbeturina në rrugë. Është me rëndësi që njerëzit të japin kontributin e tyre për pastrimin e Prizrenit dhe të mbajnë atë të bukur duke pasur në mendje se qyteti është sikur shtëpia e tyre.

2.6.3 Rritja e shpejtë e sasisë së mbeturinave

Sikurse që u përmend më lartë, popullsia është rritur për 2.1% gjatë këtyre viteve nga viti 2011 deri 2014, dhe sasia e mbeturinave është rritur për 13.1 përqind. Është parashikuar që sasia e gjenerimit të mbeturinave do të rritet për rreth 40% gjatë dhjetë vjeçarit dhe do të bëhet 57.000 ton/vit nëse vazhdohet me këtë trend.

Nëse nuk merren masat, është e qartë se do të na duhen 40 % më shumë shpenzime sesa shumat e tanishme e nevojshme për menaxhimin e mbeturinave dhe veç kësaj një deponi e re duhet të ndërtohet.

2.6.4 Vështirësitë e sigurimit të burimeve financiare

Buxheti Komunal në 2013 dhe 2014 i Komunës së Prizrenit është i paraqitur në tabelën e mëposhtme. 80% ose më shumë e buxhetit është subvencion nga niveli qendror qeveritar dhe të ardhurat siq është tatumë në pronë etj, të cilat janë vetëm 20% , bile më pak. Buxheti i alokuar për mirëmbajtjen e rrugëve, hapësirave publike, ujit dhe kanalizimit ishte rreth 25% nga shumata e përgjithshme, kurse për menaxhimin e ishte vetëm 2% deri në vitin 2013. Buxheti për menaxhimin e mbeturinave ishte siguruar vetëm për pastrimin e hapësirave publike, kështu që nuk kishte buxhet për mbeturina komunale. Trajtimi i mbeturinave urbane ju ishte lënë Ekoregjionit dhe kompanive private, kështu që KeP nuk kishte alokuar buxhet për këtë fushë.

Pasiqë pushteti lokal duhej të menaxhonte mbeturinat e veta conform me ligjin mbi mbeturinat i cili u amendamentuar, KeP vendosi që të implementojë planin e parë Pesë Vjeçar për menaxhimin e mbeturinave të nguta dhe hartoi edhe rregulloren për menaxhimin e mbeturinave në Shtator 2013. Në sistemin e ri të menaxhimit të mbeturinave, tanimë të prezantuar, KeP kontraktin shërbimit e grumbullimit të mbeturinave duke u ofruar të gjithë qytetarëve shërbim të barabartë. KeP për vitin fiscal 2014 ka alokuar 1.0 milion Euro për kontraktimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave. Implementatimi i planit u shty për një vit për shkak të ndikimit të zgjedhjeve lokale të cilat u mbajtën në fund të vitit të njëjtë. Për atë arsye KeP e përdori një pjesë të buxhetit të 2014 vetëm për prokurimin e kompostërëve shtëpiak dhe për promovimin e edukimit mjedisor.

Tabela 5: Buxheti Komunal nga 2013 dhe 2014

Pikat	2013	2014
Të hyrat e përgjithshme	33,628,746 (100%)	35,877,659 (100%)
Të hyrat vetanake	6,119,080 (18.2%)	6,425,034 (17.9%)
Subvencionet nga qeveria qendrore	27,509,666 (81.8%)	29,452,625 (82.1%)
Bugjeti për DSHP	8,400,899 (25.0%)	9,167,743 (25.6%)
Menaxhimi i mbeturinave	670,000 (2.0%)	1,700,000 (4.7%)
I arje-fshirja	670,000 (2.0%)	700,000 (2.0%)
Administrata për menaxhim të mbeturinave	0 (0.0%)	1,000,000 (2.8%)
Popullsia	182,480	183,595
Bugjeti komunal/person	184.29 €/person	195.42 €/person
Bugjeti i menaxhimit të mbeturinave/person	3.67 €/person	9.26 €/person

Sikurse u cek më herët, 80% ose më shumë e buxhetit komunal mbulohet nga niveli qendror. Sidoqoftë, koha e marrjes së subvencionit vendoset varësisht nga situata monetare e nivelit qendror. Grumbullimi dhe shkarkimi i mbeturinave ka një kosto të lartë menaxhimi. Nëse pagesa për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave vonohet, gjendja financiare e ofruesve të shërbimit vështirësohet tej mase. Kjo ndikon edhe në grumbullimin e mbeturinave nga qytetarët. Për këtë arsye, Komuna ka vendosur të prezantojë taksën për mbeturina për të siguruar fondin e vet-financimit dhe me kontraktimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave të ofroj shërbim më kualitativ dhe të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët.

Ngase taksa për mbeturinat inkasohet përgjatë gjithë vitit, Komuna siguroi një milion Euro nga subvencionit i nivelit qendror për të mbuluar shpenzimet e tanishme të shërbimit. KëP synon që të jetë në gjendje të menaxhoj mbeturinat vetëm me taksën e inkasuar, kështu që më në fund të mos ketë nevojë për mbështetje me subvencione nga niveli qendror.

**Plani Master për Menagjimin e Mbeturinave të
Ngurta**

1 Filozofia themelore e menaxhimit të mbeturinave

Komuna e Prizrenit (KeP) do të krijoj një sistem të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave deri me 2018, dhe do të bëjë përpjekje të krijoj një model qyteti mjedisor ku qeverisja në bashkëpunim me qytetarët dhe bizneset afariste promovojnë 3 R dhe e krijojnë një shoqëri të ciklit material deri në vitin 2023. Në këtë mënyrë, KeP do të përpiqet që të krijoj një sistem të qëndrueshëm financiar të menaxhimit të shëndoshë të mbeturinave të ngurta.

KeP do të krijoj sistemin e MMN duke prezentuar sistemin e taksës për mbeturina dhe kontraktimin e shërbimit të grumbullimit e që ka filluar së aplikuari në Kosovë për herë të parë prej vitit 2015, si një sistem i qëndrueshëm i cili do të jetë në zhvillim deri në fund të 2018 dhe me këtë të përmbushë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave ku secili qytetar gëzon të drejtën e barabartë.

KeP do të promovojë 3 R për të minimizuar mbeturinave si një qytet model i avancuar në Kosovë, ku qytetarët, bizneset dhe qeverisja lokale punojnë së bashku.

Taksa për mbeturina e cila mbledhet nga qytetarët investohet në menaxhim të mbeturinave pa humbur para dhe duke i siguruar një mjedis të përshatshëm shoqërisë.

KeP do të përpiqet të siguroj transparence duke i publikuar çdo vit të dhënat e menaxhimit të mbeturinave.

2 Objektivat e Planit

2.1 Periudha e Planifikimit

Periudha e planit master për MMN është dhjetë vjeçar duke filluar nga Janari 2014 deri në Dhjetor 2023 dhe kjo periudhë ndahet në dy mandate dhe ofrohet edhe objektiva e afërt, respektivisht.

2014 - 2018: Krijimi i sistemit të shëndoshë të Menaxhimit të Mbeturinave.

2018 – 2023: Sfidimi i krijimit të një shoqërie të ciklit material duke promovuar 3 R.

KeP tanimë ka miratuar planin e parë 5 vjeçar për gjysmën e parë për periudhën prej 2014 deri 2018. Nisur nga fakti se sigurohen të hyrat nga taksa për mbeturina për implementim dhe është paraparë kontraktimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në planin e parë 5 vjeçar, në këtë master plan parashihet reduktimi i mëtejme i mbeturinave.

2.2 Vizioni i menaxhimit të mbeturinave të ngurta

Për të siguruar një mjedis të pastër për fëmijët tanë, KeP përshkruan vizionet si më poshtë për nga këndvështrimi i administrimit të mbeturinave dhe do të bëjë përpjekje ta arrijë atë.

Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve për Menagjimin e mbeturinave
drejt një Shoqërie të Shëndoshë në Republikën e Kosovës

JICA

1. Prizreni të bëhet një qytet i bukur dhe i pastër.

Krijimi i një qyteti të bukur me krenari dhe kënaqësi që është qyteti ynë, keP do të bëjë çmos që të mirëmbajë rregullat e shkarkimit dhe të bëjë aktivitetet e zbulimit të qytetit, të ndaloj hedhjen e mbeturinave dhe hudhjet ilegale duke promovuar një menaxhim të mbeturinave me bashkëpjesëmarrje.

2. Prizreni do të bëhet një qytet i lakmuar për jetesë ku qytetarët nuk kanë problemin e mbeturinave.

KeP do të bëjë përpjekje të qasat çeshtjeve duke i menduar ato për nga këndvështrimi i qytetarëve për të korresponduar me strukturën sociale dhe nevojat e ndryshme të qytetarëve.

Rrjedhimisht, problemet e shkarkimit të mbeturinave, pikat e shkarkimit etj., dhe gjërat të cilat lidhen me qytetarët, do të zgjidhen.

Për më shumë, me përgjegjësinë e duhur dhe të drejtë të qytetarëve dhe administratës, do të krijohet një mekanizëm i qëndrueshëm i masave për mbeturinat.

3. Të gjithë qytetarët janë të përfshirë në aktivitetet e 3R

Qytetari do të mundohet që të gjeneroj sa më pak mbeturina në shtëpi, dhe biznesi afarist do të blej produkte të cilat nuk gjenerojnë shumë mbeturina dhe do të shes ato. Në këtë formë secili qytetar do të qaset reduktimit të mbeturinave.

Mbeturinat e gjeneruara ndahen në mbeturina organike dhe jo-organike të burimi gjenerues dhe ashtu grumbullohen. Mbeturina organike reciklohet si kompost dhe të reciklueshmet ndahen nga mbeturinat jo-organike dhe dërgohen në fabrikat e reciklimit dhe pastaj kthet në logjistikë si një produkt.

4. Mbetjet nga Mbeturinat procesohen si duhet dhe shkarkohen si duhet

Edhe pse mbeturinat reduktohen, ri-përdoren dhe reciklohen përmes aktivitetëve 3R, prapë gjenerohen mbetjet. Këto mbetje grumbullohen dhe trajtohen si duhet, dhe në fund deponohen me metodën e kompaktimit duke ulur ndikimin negativ mjedisor sa më shumë të jetë e mundur.

Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve për Menagjimin e mbeturinave
 drejt një Shoqërie të Shëndoshë në Republikën e Kosovës

JICA

2.3 Objektivat Numerike

Tabela 7: Objektivat numerike të Planit Master për MMN

Pikat	2011	2014	2018	2023
1. Shkalla e grumbullimit të mbeturinave	75.7%	87.7%	100.0%	100.0%
2. Eliminimi i pikave ilegale	22.7%	11.4%	0.0%	0.0%
3. Ulja e shkallës së deponimit final	93.7%	93.0%	68.2%	41.5%
4. Shkalla e reciklimit	5.7%	6.6%	32.9%	62.5%

1. Grumbullimi i mbeturinave

KeP me 2018 do ti grumbulloj të gjitha mbeturinat e shkarkuara.

2. Eliminimi i pikave ilegale

KeP do të bëjë përpjekje të heq hudhjet ilegale nga zona komunale deri në fund të vitit 2018.

3. Reduktimi i sasisë së deponuar finale

KeP synon që të ulë sasinë e deponuar deri në gjysmë për 10 vitet e ardhshme përmes aktiviteteve të promovimit të 3R, siç edhe ceket më poshtë.

4. Promovimi 3R

KeP do të përpaket që të promovojë 3R për reduktimin e mbeturinave dhe të arrij shkallën e reciklimit në 60% e cila është përqindja e sasisë së gjeneruar për 10 vitet e ardhshme.

Vlerësimi i sasisë së mbeturinave të gjeneruara në të ardhmen

Edhe pse është parashikuar se popullsia do të ketë rritje me 4.6% nga 2014, sasia e mbeturinave të gjeneruara rritet me 22.5% në të njëjtë periudhë. Kjo ndodh për shkak se sasia e mbeturinave të gjeneruara rritet shpejtë me rritjen e konsumit nga qytetarët gjatë ngritjes së standardeve të jetesës. Nëse nuk bëhet asgjë në këtë rast, jo vetëm që paraqitet nevoja që deponia finale të zhvillohet më herët por ngritet edhe ndikimi negativ mjedisor i deponisë ekzistuese duke e shtuar gjenerimin e gasit metan dhe ndotjen e ujërave nëntoksore që shkaktohen nga rrjedhjet e ujërave të zeza e që mund të bëhen serioze. Prandaj, KeP do të mirëmbajë mjedisin me së miri duke u përpjekur që të reduktojë mbeturinat në dhjetë vitet e ardhshme.

Tabela 8: Parashikimi i Sasisë së mbeturinave të gjeneruara në të ardhmen

	Njesia	2014	2018	2023
Popullsia	Person	183,595	187,736	192,105
Sasia e gjeneruar e mbeturinave	ton/vit	46,766	51,859	57,304

Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve për Menagjimin e mbeturinave drejt një Shoqërie të Shëndoshë në Republikën e Kosovës

JICA

3 Përgjegjësia e qytetarëve, ndërmarrjeve dhe administratës

KeP prezanton sistemin e grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave komunale siç tregohet në figurën më poshtë, dhe një sistem i tillë ka filluar së implementuari në Janar 2015. Për të zhvilluar këtë sistem në vazhdimësi, qytetarët, ndërmarrjet dhe qeverisja lokale duhet mbajë përgjegjësit e veta.




Figura 9: Sistemi i grumbullimit dhe transportimit i prezantuar me 2015

3.1 Qytetarët

Qytetarët do të kenë mirëkuptim dhe të brengosen për problemet mjedisore dhe në mënyrë të pavarur të kryejnë aktivitete 3R, të praktikojnë minimizimin dhe reciklimin e mbeturinave dhe zbukurimin e qytetit. Rrjedhimisht ata të krijojnë një qytet ku do të jetojnë në pastërti dhe të shëndetshëm.

Kur qytetarët të zgjedhin një artikull për blerje, duhet ti jepet prioritet atyre me më pak paketim dhe të ri-përdorshëm, qëndrueshëm ose mallra të ri-procesuara. Konsumatori duhet të përdor produktet duke i përdorur sa më gjatë, ose duke i riparuar ato dhe të reduktojë sasinë e vetë për shkakim. Poashtu, qytetarëve u kërkohet të bashkëpunojnë për ndarjen e mbeturinave të tyre sipas kategorive për grumbullimin e mbeturinave nga qeverisja lokale për të promovuar reciklimin e përshtatshëm.

Përpjekjet konkrete

- Qytetarët të kenë vullnetin të zgjedhin dhe blejnë produkte ekologjike mjedisore.
- Qytetarët shfrytëzojnë me kujdes produktet për një kohë më të gjatë dhe nuk pranojnë ato të panevojshmet të cilat bëhen mbeturinë.

Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve për Menagjimin e mbeturinave
drejt një Shoqërie të Shëndoshë në Republikën e Kosovës

JICA

- Qytetarët janë të vetëdijshëm për koston e trajtimit të mbeturinave të cilat ata i shkarkojnë dhe i klasifikojnë ato me kujdes.
- Qytetarët aktivisht i bashkangjiten aktiviteteve të minimizimit të mbeturinave, reciklimit, fushatave të zbulimit dhe mbajnë përgjegjësitë të cilat u takojnë.

3.2 Bizneset afariste

Bizneset afariste si shkarkues të mbeturinave, kryejnë aktivitete të cilat konsiderojnë mjedisin. Bizneset afariste përpiqen të krijojnë një qark mjedisor dhe ekonomik duke prodhuar dhe shitur mallra ekologjike të cilat janë ngarkesë të vogël mjedisore.

Bizneset afariste janë përgjegjëse për shkarkimin e mbeturinave të gjeneruara në procesin e aktivitetit të tyre. Kur bizneset të zgjedhin lëndën e parë për procesin e prodhimit, duhet të marrin në konsideratë reduktimin e sasisë së shkarkuar, reciklimin dhe ri-përdorimin. Atëherë kur bëhen përpjekjet për reduktimin e mbeturinave, ri-përdorimin ose reciklimin, bizneset afariste duhet të sigurojnë metodat e përshtatshme të trajtimit të mbetjeve nga ato mbeturina, në mënyrë që të bëhet shkarkimi si duhet.

Poashtu, sa i përket prodhimit, procesimit dhe shitjes së produkteve, bizneset afariste duhet të përpiqen të i thjeshtësojnë produktet dhe enët apo mbështjellsin. Të prodhojnë dhe shesin produkte të qëndrueshme, të ri-përdorshme, të përmirësues mundësit e riparimit dhe të jepen informacione të mjaftueshme për reduktimin e sasisë së shkarkuar si dhe implementimin e reciklimit, ri-përdorimit dhe trajtimit.

Përpjekjet konkrete

- Bizneset afariste promovojnë ndarjen e plotë dhe reciklimin aktiv dhe mbetjet i procesojnë si duhet.
- Bizneset afariste përdorin burime të recikluara aktivisht si material prodhues.
- Bizneset afariste do të avancojnë me qasje ku gjatë prodhimit të produktit i cili zgjatë më shumë, të mos gjenerohet mbeturinë duke e thjeshtëzuar mbështjellsin e enës dhe duke mundësuar riparimin etj.
- Bizneset afariste do të ofrojnë informata vetëdijësuese mbi çështjet mjedisore dhe produktet në mënyrë që qytetarët të zgjedhin aktivitetet 3R.

3.3 Administrata

KeP do të bëjë përpjekje të nxis qytetarët dhe bizneset që të kenë interes në problemet mjedisore të shkaktuara nga mbeturinat dhe të promovojë aktivitetet konkrete përmes promovimit të shërbimit të informimit, edukimit mjedisor dhe vetëdijësimit të zhvilloj mekanizmat e 3R në atë mënyrë që qytetarëve të ju rritet dëshira vetëvetiu.

KeP do të promovojë aktivitetet vullnetare në drejtim të reduktimit të shkarkimit të mbeturinave brenda juridiksionit të vetë përmes aktiviteteve të ngritjes së vetëdijësimit. Shërbimeve me informacione, Edukim publik etj. KeP bënë përpjekje të minimizojë sasinë e

Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve për Menaxhimin e mbeturinave
drejt një Shoqërie të Shëndoshë në Republikën e Kosovës

JICA

shkarkuar të mbeturinave të Ngurta Komunale duke promovuar grumbullimin ndaras dhe aktivitetet e reciklimit.

KeP do të kryej analizën e kostos për menaxhimin e mbeturinave dhe shërbimet e informacionit bazuar në aspektet socio-ekonomike të cilat dalin nga ato analiza. Kur Komuna e Prizrenit të prezantojë një sistem të ri ose ndryshoj atë ekzistues përmes ndryshimit të kategorive të grumbullimit ndaras dhe/ose metodat e shkarkimit, do të përpiqet tu sqarojë qytetarëve dhe bizneseve afariste nevojën dhe të mirat socio-ekonomike të sistemit të ri ose atij të rishikuar.

Për-pjekjet konkrete

- KeP zhvillon mekanizmat e 3R ku edhe qytetarët edhe bizneset afariste mund të jenë pjesëmarrës.
- KeP promovon shërbimin e informacionit, edukimin mjedisor dhe vetëdijësimin për të përkrahur aktivitetet e pavarura të qytetarëve dhe bizneseve afariste.

4 Rishikimi i Rrjedhës së Mbeturinave


Rrjedha e mbeturinave e paraqitur në Kapitullin 2.5 është ajo e bërë nga rezultatet e studimit pëmbajtësor konform me rrjedhën e mbeturinave sa më aktuale të mundshme.

KeP ka filluar sistemin e ri të MMN që nga Janari 2015 në bazë të planit 5 vjeçar të MMN në mënyrë që secili qytetar të gëzojë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave. Si rezultat, pritet që të eliminohen ato mbeturina të hedhura ilegalisht në ato zona rurale ku nuk është ofruar shërbimi i grumbullimit të mbeturinave dhe ato janë sjellur në zonat urbane.

Përmes projektit të JICA-s, ne kemi kuptuar se deponia në Landovicë do të mbushet me mbeturina deri në vitin 2021 nëse nuk bëjmë asgjë që të ndalim këtë rritje të sasisë së mbeturinave. Pasiqë, për të zhvilluar një deponi të re kërkohet një kohë e gjatë sepse janë shumë vështirësi e njëra prej tyre është arritja e pajtueshmërisë së komunitetit etj. KeP do të promovojë aktivisht 3R dhe do të punojë në reduktimin e mbeturinave duke përdorur deponinë ekzistuese sa më shumë që të jetë e mundur.

Përmes ndarjes së mbeturinave është e domosdoshme të promovohet përmes promovimit të 3R, rrjedha e mbeturinave e sqaruar në pikën e mësipërme mbi gjendjen aktuale, nuk është e përshtatshme të sqaroj menaxhimin e mbeturinave në të ardhmen përfshirë minimizimin e mbeturinave përmes aktiviteteve të 3R. Prandaj, KeP ka rishikuar rrjedhën e mbeturinave ashtu siq edhe paraqitet në faqen tjetër.

Mbeturinat ndahen në ato organike dhe jo organike të burimi i shkarkimit dhe KeP grumbullon mbeturinat ndara në ditë të ndara dhe i transporton te premiset e trajtimit të ndërmjetëm. Objektiva numerike e minimizimit të mbeturinave pas trajtimit të ndërmjetëm përshkruhet më tutje.



Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve për Menagjimin e mbeturinave JICA
 drejt një Shoqërie të Shëndoshë në Republikën e Kosovës

5 Strategjitë për Implementimin e Vizionit

Vizioni	Strategjitë
5.1 Realizohet qyteti i pastër dhe i bukur.	5.1.1 Promovimi i krijimit të një bashkëpunimi në mes të qytetarëve, bizneseve dhe Komunës të cilët janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre në menaxhimin e mbeturinave.
5.2 Prizren bëhet një qytet o jetueshëm ku qytetarët nuk mërziten nga mbeturinat.	5.2.1 Përmirësimi i sistemit të ri të menaxhimit të mbeturinave i cili kishte filluar në 2015
	5.2.2 Zhvillimi i trajtimit të përshtatshëm të mbeturinave industriale dhe farmaceutike.
5.3 Të gjithë qytetarët kryejnë aktivitetet të 3R.	5.3.1 Prezantimi i ndarjes në burim dhe grumbullimi i mbeturinave ndaras.
	5.3.2 Prezantimi i impiantit për trajtim të ndërmjetëm për reduktimin e sasisë së shkarkimit të mbeturinave.
	5.3.3 Rishikimi i rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave.
5.4 Mbetjet trajtohen si duhet dhe shkarkohen.	5.4.1 Monitorimi i deponisë ekzistuese.
	5.4.2 Krijimi i menaxhimentit për deponim të përshtatshëm final.

5.1 Qyteti i Pastër dhe i Bukur

5.1.1 Promovimi i dukurisë ndër qytetare, bizneseve dhe qeverisë lokale që të bëhen më të vetëdijshëm në përgjegjësitë e tyre dhe të ndërtojnë një komunitet duke e mbështetur njeri tjetrin

Të promovohet qytetari, biznesi dhe qeveria për tu vetëdijësuar për përgjegjësitë e tyre ndaj krijimit të një komuniteti duke e mbështetur njeri tjetrin, KeP do të ketë përpjekje me kujdes të vazhdueshëm drejt aktiviteteve që pasojnë .

Orari i Implementimit të Aktiviteteve Krvesore

Aktivitetet	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
1. Të sigurohen informata mbi çështjet e menaxhimit të mbeturinave dhe ato mjedisore.										
2. Të kryehen aktivitete për edukim mjedisor (shkolla, publiku i përgjithshëm)										
3. Të promovohet pjesëmarrja publike (Programi adoptues, Rruga ime, etj.)										
4. Të promovohen njohuritë e përbashkëta dhe aktivitete vetëdijësuese për eliminimin e hudhjes së mbeturinave dhe deponimit.										

1. Shërbimi i informimit për menagjimin e mbeturinave

Menagjimi i mbeturinave mund të kthehet në një sistem të përshtatshëm nëse, qytetarët, bizneset dhe KeP do të praktikojnë përgjegjësitë e tyre të përmendura në paragrafin e mëparshëm. Për avancimin e sistemit drejt pastrimit të qytetit të bukur dhe shoqërisë së shëndoshë, KeP do të përpiqet që të implementojë si më poshtë. Për më shumë, KeP do të publikojë të dhëna bazuar në statistikat dhe analizat, të cilat do të jenë efikasitetet e aktiviteteve të 3Rs dhe kostoja e kërkuar për trajtimin e mbeturinave, kështu që qytetarët dhe bizneset do ta kuptojnë rëndësinë e tyre. Informatat që do të

Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve për Menagjimin e mbeturinave JICA
 drejt një Shoqërie të Shëndoshë në Republikën e Kosovës

ndahet në publik do të jenë metodat e ndarjes së mbeturinave dhe shkarkimi i tyre etj... KeP do të përpiqet të ngris vetëdijen mjedisore të qytetarëve dhe bizneseve duke u ofruar informatat e nevojshme conform objektivave.

Pikat	Aktivitetet
<ul style="list-style-type: none"> Shpërndarja efikase e informatave duke përdorur disa mundësi dhe mediat 	<ul style="list-style-type: none"> KeP përpiqet që të siguroj informata të cilat qytetarët mund ti marrin duke i përdorur: <ul style="list-style-type: none"> Mediat masive sikur që është TV, radio Webfaqe, gazeta, etj.
<ul style="list-style-type: none"> Siguron informata të sakta dhe të kuptueshme lehtë. 	<ul style="list-style-type: none"> KeP përpiqet të siguroj informatat si më poshtë, të cilat janë të sakta dhe informata që kuptohen lehtë të bazuara në të dhënat e marra nga statistikat dhe analizat. <ul style="list-style-type: none"> Gjenerimi i mbeturinave sipas parashikimit Sasia e mbeturinave të deponuara dhe regjistruara Të dhënat në lidhje me 3R: Instalimi i komposterëve shtëpiak, sasia e ricikluar, sasia e kompostuar, etj. Të dhëna financiare (kostoja e grumbullimit të mbeturinave, kostoja e shkarkimit të mbeturinave, etj.)

2. Implementimi i edukimit mjedisor

KeP do të përpiqet që të freskojë për vetëdijësimin dhe edukimin mjedisor dhe ti përdorë këto nëpër shkolla dhe komunitete pozitivisht.

Pikat	Aktivitetet
<ul style="list-style-type: none"> Edukimi Publik 	<ul style="list-style-type: none"> Të zhvillohet promovimi i materialeve të 3R (2016 -) Të inicohet ndarja në burim nëpër institucione (2017 -)
<ul style="list-style-type: none"> Edukimi mjedisor nëpër shkolla 	<ul style="list-style-type: none"> Të krijohen materiale të ndryshme edukimi në përputhje me klasat Të mbahen trajnime me mësues/arsimtarë Të organizohen "Grupe Ekologjike" (2014 -) Të organizohen Gara të Pastërtisë në mes të shkollave (2016 -)

3. Promovimi i pjesëmarrjes publike

KeP po synon që të krijoj një sistem të bashkëpjesëmarrjes të menaxhimit të mbeturinave. Prizreni si vendi ku jetoni duhet gjithnjë të jetë një vend i pastër dhe komod me një natyrë të pasur. Një vend i tillë për jetesë nuk mund të krijohet vetëm nga KeP. Por, nëse qytetarët nuk hedhin mbeturina, i largon gjithet e rëna dhe i largon mbeturinat nga hapsirat e hapurapublike atëherë ky është vendi ku mund të jetohet.

Derisa individualisht mund të jetë e vështirë të kryhen këto aktivitete, KeP po grupon metoda trajtuese ku qytetarët që jetojnë buzë rrugës ose i përdorin parqet, ti mirëmbajnë ato hapësirat mire duke punuar së bashku. Për më shumë, KeP do të kryej rregullisht studimin e opinionit publik për të kuptuar ndjenjat e qytetarëve për hapësirat ku jetojnë ata dhe për të marrë opinionin dhe sugjerimet e qytetarëve për të përgatitur planin e ardhshëm të veprimit.

Pikat	Aktivitetet
<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja Publike 	<ul style="list-style-type: none"> Të promovohet qyteti im Të promovohet programi i Adopimit <ul style="list-style-type: none"> përcaktimi i parqeve/rrugëve publike që do të synohen në program

Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve për Menagjimin e mbeturinave JICA
 drejt një Shoqërie të Shëndoshë në Republikën e Kosovës

- Të kryhet periodikisht studimi i opinionit publik

- Promovimi i dijës së përgjithshme dhe aktivitetet vetëdijësuese për eliminimin e hudhjes dhe shkarkimit ilegal
- Të gjithë e dinë se hudhja e mbeturinave dhe shkarkimi ilegal është vepër e ligë. Sidoqoftë, nuk zhduken ata persona të cilët hedhin letërën e sheqerkave dhe cigaren etj, duke ecur. Jo vetëm qytetarët por edhe turistët veprojnë në këtë mënyrë. Përse?

KeP do të përpiqet ti udhëzoj të gjithë mbi veprimet të cilat nuk duhet të bëhen.

Pikat	Aktivitetet
• Ngritja e Moralit	<ul style="list-style-type: none"> • Të reklamohet Ilogoja dhe Slogani për parandalimin e hudhjes së mbeturinave • Të implementohet periodikisht fushata e pastrimit
• Shërbimi informues për turistët	<ul style="list-style-type: none"> • Të instalohen labelat • Të printohen Ilogoja dhe slogani mbi udhëzuesin për udhëtim etj.

5.2 Pa probleme të mbeturinave

